



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2444, datë 10.04. 2014

Për

**Shqyrtimin e ankimit administrativ të Altelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 2415, datë 04.02.2014 për "Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese".**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 10.04.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", shqyrtoi çështjen me objekt:

**Shqyrtimi i ankimit administrativ të Altelecom sh.a. ndaj Vendimit nr. 2415, datë 04.02.2014 për "Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese".**

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
3. Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike";

4. "Rregullore për analizën e tregut", miratuar me vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, ndryshuar me vendimin nr. 2342, datë 31.07.2013, të Këshillit Drejtues të AKEP (*Rregullorja*);

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 982/1Prot., datë 10.3.2014 (*nr. 576Prot. i AKEP, datë 10.3.2014*) me anë të së cilës ka paraqitur ankim administrativ me objekt ndryshimin/modifikimin e Vendimit nr. 2415, datë 04.02.2014 për "*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese*".
1. Vendim Nr. 2340 datë 31.07.2013, Për "*Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë: segmentet terminuese dhe trunk – Këshillim Publik*";
2. Vendim Nr. 2414 datë 04.02.2014, Për "*Miratimin e Dokumentit: "Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë: segmentet terminuese dhe trunk - Dokumenti Përfundimtar*";
3. Vendim nr. 2415, datë 04.02.2014 për "*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese*".
4. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

Albtelecom sh.a. me anë të shkresës nr. 982/1Prot., datë 10.3.2014, ka paraqitur ankim administrativ me objekt ndryshimin/modifikimin e Vendimit nr. 2415, datë 04.02.2014 , për "*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese*".

Albtelecom sh.a. shprehet se në këtë ankim i është përmbajtur qëndrimeve të tij në komentet e parashtruara gjatë procesit të këshillimit publik të dokumentit të analizës së tregjeve të linjave me qira në **(1)** tregjet me pakicë të minimumit të linjave me qira, **(2)** tregun me shumicë të linjave kryesore trunk dhe **(3)** tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira.

1. Albtelecom argumenton duke iu referuar Vendimit nr. 2415, se përjashtimi nga lista e tregjeve në rregullim të linjave me qira në nivel pakice, si dhe në tregun me shumicë të segmenteve trunk dhe revokimi i statusit FNT të Albtelecom për këto tregje, përbën argument domethënëse se edhe për tregun me shumicë të segmenteve terminuese Albtelecom nuk gëzon status FNT. Argumentet e parashtruar në analizë për FNT shërbejnë si emërues i

përfundimeve lidhur me të tre segmentimet e tregut, si tregje në raporte komplementare dhe që ndikojnë te njëri tjetri.

2. Albtelecom shprehet se, gjatë procesit të analizës së tregut për gjetjen me FNT në segmentet e tregjeve të linjave me qira për periudhën e analizuar AKEP nuk ka identifikuar probleme, që mund të kenë dëmtuar konkurrencën efektive ç'ka do të bënte të nevojshme ndërhyrjen ax-ante. Referimi në problematika që mund të kenë ekzistuar në periudha të kaluara nuk mund të përbëjë argument për t'u konsideruar aktualisht. Albtelecom i kërkon AKEP të përcaktojë më qartë dhe të detajojë shërbimin e linjave me qira dhe të produkteve që ofrohen si pjesë e këtij shërbimi, pasi në raportimet periodike gjithnjë janë ndeshur paqartësi dhe mund të jenë përfshirë të dhëna që nuk përkojnë me këtë shërbim, duke ndikuar në krijimin e një panorame joreale për pjesët përkatëse të operatorëve që operojnë në këtë treg.
3. Vendimi i AKEP për përcaktimin e tregut të segmenteve terminuese të Albtelecom me FNT mbështetet tërësisht mbi vlerësimin e pjesëve të tregut. Të dhënat statistikore të situatës aktuale nuk mund të përcaktojnë perspektivën në dinamikë të zhvillimit të tregut të linjave me qira dhe segmenteve terminuese në veçanti. Referuar të dhënave të analizës, Albtelecom vijon të humbasë pjesë tregu në numër linjash me qira dhe në të ardhura. Pjesët e tregut të Albtelecom në nivel pakice janë reduktuar ndjeshëm. Ky realitet nuk mund të paraqitet i shkëputur nga tregu me shumicë i segmenteve terminuese.
4. Albtelecom shprehet se në treg gjendet më shumë se një operator që disponon rrjet backbone kombëtar, në dimensione të krahasueshme me Albtelecom. Vodafone dhe AMC zotërojnë teknologji 3G, që lejon ofrimin e këtyre shërbimeve. Po ashtu edhe operatorët alternativë në mjaft zona dëshmon për konkurrencë dhe mundësi zgjedhjesh në treg.
5. Albtelecom shprehet se në tregun përkatës të segmenteve terminuese po përballet me një konkurrencë gjithnjë e në rritje që ka ardhur si pasojë e zhvillimit të kërkesës dhe ofertës dhe jo e masave rregulluese. Albtelecom ofron shërbimet e segmenteve terminuese të linjave me qira nën tarifat maksimale për shkak të presionit dhe konkurrencës efektive në treg.
6. Albtelecom shprehet se nuk ekzistojnë barriera të larta të natyrës ligjore, rregullatore, teknologjike apo ekonomike për hyrjen në këtë treg të operatorëve të tjerë. Ofrues të rinj kanë rritur presionin negociues në treg, duke ulur çmimet ofruara nga Albtelecom për segmentet terminuese kombëtare.
7. Albtelecom shprehet se pavarësisht Rekomandimit të KE 2007, situata duhet analizuar në varësi të kushteve të tregut ku implementohet (referuar paragrafit 3 të Rec.2007). Rivendosja e detyrimeve kur Albtelecom ka kryer investime në rrjetin fiks (82 % e investimeve në Shqipëri) përbëjnë barrë të rëndë joproportionale referuar nenit 15/2 të ligjit 9918 i ndryshuar.

Albtelecom shprehet se nuk mund të gjykohet nga pozitat kur konsiderohej si ofruesi më i madh dhe me shtrirje gjeografike më të madhe në tregun

shqiptar të linjave me qira, mbi të cilin duhet të vazhdojnë të rëndojnë detyrime, të cilat nuk justifikojnë qëllimin për të cilin janë vendosur.

Sa më lart Albtelecom, i kërkon AKEP që të rishikojë dhe rivlerësojë pozicionin e tij në këtë treg, dhe bazuar në nenin 138/1 dhe nenin 146/b të K.Pr.A:

*Të ndryshojë/modifikojë VKD nr. 2415, datë 4.2.2014, për “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese”.*

Sa më lart AKEP arsyeton, se:

Siç shprehet vetë Albtelecom në këtë ankimim, argumentet e trajtuara janë paraqitur edhe në komentet e sjella pas këshillimit publik të dokumentit të analizës së tregut në periudhën përkatëse, komente të cilat janë trajtuar nga AKEP në dokumentin final të analizës për të cilat është mbajtur qëndrimi përkatës i cili gjendet në dokumentin përfundimtar të analizës në Ankes 1, i detajuar. Por pavarësisht këtij qëndrimi të mbajtur, në lidhje me pretendimet e paraqitura në këtë ankimim, vihet re një trajtim teorik i pretendimeve, të pambështetura me të dhena shtesë që provojnë pretendimet përkatëse.

Përcaktimet e bëra për tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira, si dhe qëndrimi përkatës në dokumentin final të analizës së tregut, është i mbështetur në faktorë konkret të analizuar si: pjesë tregu, zhvillimi e konkurrencës në këtë treg, faktorët e fuqisë kundërvepruese si dhe arsyetime të përdorura që mbështesin qëndrimet e AKEP.

Arsyetimet e përdorura nga AKEP si dhe vlerësimet e bëra për market share prej rreth 75 %, qoftë në kapacitete dhe në të ardhura, si dhe faktin që KE në arsyetimin e përdorur për të hequr tregun e trunk segmenteve nga lista e tregjeve të nevojshme për ndërhyrje ex-ante, nën këndvështrimin që përputhet edhe me arsyetimin e Albtelecom se tregu segmenteve terminuese dhe tregu i trunk segmenteve (kanë natyrë plotësuese) për njeri tjetrin, është vlerësuar se vendosja e masave të duhura rregullatore në tregun e segmenteve terminuese, krijon hapësirat e duhura që të jetë konkurrues edhe tregu i trunk segmenteve edhe në se ky treg nuk është i konsideruar i nevojshëm për ndërhyrje ex-ante. Kjo është në mbështetje të zhvillimit të konkurrencës në këto tregje por edhe në analogji me praktikatat e ndjekura në këto tregje nga KE dhe vendet e rajonit.

Të gjithë faktorët e vlerësuar në analizën e bërë, si dhe konkluzioni i arritur për tregun me shumicë të segmenteve terminuese, duke përfshirë në tregun përkatës me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira, të gjitha kapacitetet e ofruara me qira apo të dedikuara, kanë krijuar bindjen e plotë se Albtelecom ka dominancë në këtë treg, duke përcaktuar në këtë mënyrë masat rregullatore përkatëse të cilat do të japin një shtysë më tej në zhvillimin e konkurrencës në këto tregje.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, pika a, të K.Pr.A,

## **V E N D O S:**

1. Lënien në fuqi të aktit administrativ: Vendimit nr. 2415, datë 04.02.2014 për "Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese" dhe rrëzimin e ankimit.
2. Të njoftohet Albtelecom sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**  
**PIRO XHIXHO**

## **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE